



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 684 Akti

V E N D I M
(I NDËRMJETËM)

Nr. 4, datë 10.5.2024

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 8.5.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Anton Pali, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht Durrës.

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Anton Pali me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Anton Pali do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Brunilda Bekteshi dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.12.2020 u caktua me short kryesuese komisionerja Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për

subjektin e rivlerësimit Anton Pali. Subjekti i rivlerësimit, me *email*-in e datës 26.1.2021, deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Anton Pali nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret, në datën 16.4.2024, me vendimin e ndërmjetëm nr. 2, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Anton Pali, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

8. Në datën 18.4.2024, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 29.4.2024.

9. Në datën 29.4.2024, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike, i dërgoi Komisionit parashtrimet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit. Në datat 29.4.2024 dhe 30.4.2024, pranë Komisionit është depozituar denoncimi nr. *** prot., datë 29.4.2024 dhe nr. *** prot., datë 30.4.2024, për subjektin e rivlerësimit nga e njëjta shtetase me iniciale L. M. Në datën 30.4.2024, Komisioni e njohu subjektin e rivlerësimit me denoncimin e këtij shtetasi, si dhe i kërkoi shpjegime lidhur me pretendimet e tij brenda datës 3.5.2024. Subjekti i rivlerësimit, në datën e caktuar nga Komisioni, paraqiti shpjegimet e tij dhe depozitoi dokumentacion sipas kërkimit të Komisionit, të cilat u administruan në dosjen e subjektit.

10. Komisioni, me vendimin nr. 3, datë 3.5.2024, vendosi ta ftojë subjektin për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative. Në datën 7.5.2024, Komisioni nëpërmjet postës elektronike njoftoi subjektin se seanca dëgjimore do të mbahet në datën 8.5.2024, ora 10:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 8.5.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

12. Subjekti i rivlerësimit Anton Pali mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 8.5.2024 u ndërpre, për të rifilluar në datën 10.05.2024, ora 9:45, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Subjekti i rivlerësimit Anton Pali ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Ai është përgjigjur në kohë gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

15. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; (g) shpjegimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore.

16. Komisioni vlerësoi që në këtë vendim të ndërmjetëm sipas nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Pezullimi nga detyra dhe detyrimet për të ndjekur programin e trajnimit” të trajtojë vetëm ato çështje të cilat lidhen me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke evidentuar mangësitë në aftësitë profesionale që mund të plotësohen me anë të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në nenin E dhe në pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

17. Në lidhje me dy kriteret e tjera, ato do të trajtohen në vendimin përfundimtar pasi subjekti të ketë përfunduar programin e edukimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe të jetë testuar për aftësitë e tij.

A. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

18. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar se subjektet e rivlerësimit vlerësohen sipas rastit për: (i) cilësi të pranueshme apo të papranueshme në punë; (ii) gjykim të drejtë apo të dobët; (iii) respektim apo mosrespektim të të drejtave të palëve ose viktimave; (iv) të qenit eficient dhe efektiv në masë të pranueshme apo të qenit joefektiv për të mbërritur përfundimisht në kualifikimin “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” sipas përcaktimit të nenit 44, shkronjat “a”, “b” dhe “c”.

19. Sipas përcaktimit të nenit E, pika 2, fjalia e tretë e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, në objektin e vlerësimit të aftësisë për prokurorët përfshihen kriteret e aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj (ligji nr. 84/2016 dhe me referim për procedurat e vlerësimit nga ky i fundit edhe në ligjin nr. 96/2016). Qëllimi i vlerësimit të aftësive profesionale sanksionohet drejtpërdrejt nga neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësive profesionale, me qëllim identifikimin e atyre që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre që kanë mangësi profesionale, të cilat mund të korrigjohen përmes edukimit.

20. Subjekti i rivlerësimit kualifikohet “Me mangësi” kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, me pasojë detyrimin nga Komisioni për të kryer program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës, me qëllim për të plotësuar këto mangësi brenda një viti sipas përcaktimit të nenit E, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

21. Trupi gjykues vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht në të aftë, me mangësi apo të papërshtatshëm, kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm dhe tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm.

22. Sipas përcaktimit të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësive profesionale të prokurorit vlerësohet bazuar në aspektet e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, por pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

22.1 Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

22.2 Më tej, aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si: qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të Prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të Prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

23. Sipas përcaktimit të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë organizative, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e

vlerësimit, vlerësohet në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe për të administruar dosjet gjyqësore.

23.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i kushtohet çdo çështjeje, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të Prokurorisë për një çështje.

23.2 Aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore dhe proceduar të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurat brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

23.3 Aftësia për të administruar dosjet e Prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

24. Sipas përcaktimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet nëpërmjet etikës në punë, integritetit dhe paanësinë.

24.1 Etika në punë e magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit të tillë si: rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

24.2 Integriteti i magjistratit në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm matet duke u bazuar në tregues të tillë si: rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e ILDKPKI-së.

24.3 Paanësia e magjistratit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si: përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

25. Sipas përcaktimit të nenit 76 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen nëpërmjet aftësive të komunikimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

25.1 Aftësia e komunikimit të magjistratit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën “shumë mirë” ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar.

25.2 Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe në shkëmbimin e njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

25.3 Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë si: pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e

magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike.

25.4 Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin e dërguar prej saj, në vlerësimin “shumë mirë”, në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në formim vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë 5 viteve. Shkallët e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës nga ky standard.

26. Komisioni, pasi analizoi: (i) raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë; (ii) të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme; (iii) denoncimet nga publiku dhe informacionet e aksesuara në media; (iv) dosjet penale të administruara për trajtimin e denoncimeve dhe ankesave; (v) shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe dëgjoi atë në seancë dëgjimore – arrin në përfundimin se:

26.1 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, me anë të së cilës Komisioni kishte evidentuar mangësitë profesionale në dosjet e verifikuara që lidheshin me: (a) vendime pushimi; (b) vendime mosfillimi të subjektit si prokuror i çështjes lidhur me vlerësimin profesional, sipas pikës 3 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

27. Për çështjen objekt shqyrtimi për subjektin e rivlerësimit Anton Pali, në funksion të provueshmërisë së fakteve që çojnë në vlerësimin e aftësive profesionale, janë administruar e analizuar nga Komisioni dokumentet ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nga të cilat kanë rezultuar mangësi profesionale që mund të plotësohen me anë të programit të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë vijon:

28. Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, viti 2016, për veprën penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve” të shtetasit K.H në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se subjekti ka vendosur *mosfillimin e këtij materiali kallëzues*, vendim i prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. ***, datë 18.11.2016, vendim i ankimuar nga subjekti për të cilin Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 2.5.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në këto kushte, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2019, dhe në përfundim të hetimeve të këtij procedimi penal në datën 12.10.2022 ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë pushimin e çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 8.5.2023, ka vendosur: Pranimin e kërkesës së Prokurorisë; Pushimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Rezultoi se dosja penale me vendimin nr. ***, datë 8.5.2023, i është dërguar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

28.1 Komisionit, nga verifikimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili kishte prishur vendimin e subjektit për mosfillimin e materialit kallëzues nr. ***, datë 6.7.2016, i rezultoi se detyra e lënë nga gjykata për t’u hetuar i referohej marrjes në pyetje të kallëzuesit, me qëllim sqarimin e fakteve të pretenduara prej tij lidhur me falsitetin e vendimit administrativ të kthimit të pronës të kallëzuarës nën pretendimin e radhës se palët kishin mbivendosje në pronësitë e tyre. Më tej rezultoi se subjekti ka vijuar përmbushjen e detyrës së lënë duke kryer hetime të tjera, si marrjen në pyetje të kallëzuesit, administrim dokumentacioni nga DPA, ATP, AKKP dhe dosjen gjyqësore nga Gjykata dhe, në përfundim, ka vlerësuar faktet e rrethanat e dala duke kërkuar pushimin e çështjes, vendim ky i miratuar edhe nga Gjykata e Shkollës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

28.2 Komisioni, në analizë të të dhënave të dala gjatë hetimit, konstatoi se nuk janë kryer hetime të plota lidhur me vendimin e mosfillimit për këtë çështje, konfirmuar ky konstatim edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

28.3 Në lidhje me konstatimin e Komisionit subjekti parashtrori se ai ka kryer verifikim të plotë të materialit kallëzues, mbështetur në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale¹, dispozitë që sipas subjektit i ka lejuar prokurorit të kryejë verifikime të ngutshme deri në marrjen e vendimit të mosfillimit dhe jo veprime hetimore të mirëfillta, sikurse gjykata kishte kërkuar/disponuar.

29. Lidhur me kallëzimin penal nr. *** të shtetasit F.M kundër punonjësve të administratës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi kishte rënë në dijeni të faktit se në dosjen gjyqësore civile për një konflikt 25-vjeçar pronësie, janë zhdukur, falsifikuar, zëvendësuar dokumentacion shkresor, prova që janë përdorur prej tij dhe babai i tij i ndjerë, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilën rezultoi se subjekti ka vendosur mosfillimin e këtij materiali kallëzues.

29.1 Komisioni, në analizë të të dhënave të dala, gjatë hetimit konstatoi se dukej se nuk janë kryer hetime të plota në drejtim të ballafaqimit të akteve të disponuara nga denoncuesi me ato të administruara në dosjen gjyqësore civile, ku ai ka qenë në cilësinë e paditësit, konfirmuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjekti parashtrori të njëjtin qëndrim si në pikën 28.3.

30. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm në këto dy çështje objekt shqyrtimi, konstaton se dispozita penale e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, e lë në diskrecion të prokurorit verifikimin nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal. Në këtë drejtim, trupi gjykues, referuar të dyja vendimeve të mosfillimit për çështjet e pasqyruara në pikat 28 e 29 të këtij vendimi, konstaton se subjekti ka disponuar me vendime mosfillimi duke referuar si argument dispozitën/nenin 290, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale, duke arsyetuar se ka rezultuar e provuar se nuk plotësohen elementet e figurës penale. Në çështjen objekt vlerësimi subjekti, duke iu referuar shkronjës “ç” të kësaj dispozite, e ka lidhur mosfillimin me vetë ekzistencën e veprës penale. Që subjekti të arrinte në këtë përfundim pa filluar çështja penale, për pasojë pa kryer hetime të plota që lidhen me rrethanat e kallëzuar, në vlerësim të trupit gjykues, duhet të konstatohe qartazi që fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga Kodi Penal si vepër penale. Çmuar në këtë interpretim të dispozitës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka munguar në kryerjen e analizës ligjore të argumentuar, që nëse fakti ekziston ose jo, përfundim ky i cili do të duhej të dilte vetëm pasi të ishin kryer hetime shteruese për rrethanat e kallëzuar, sikurse do të ishte pyetja e personave të kallëzuar apo ballafaqimi i dokumentacionit sipas pretendimit të kallëzuesit. Në vlerësimin e trupit gjykues, tjetër situatë ligjore është nëse fakti nuk parashikohet si vepër penale dhe tjetër nëse fakti nuk ekziston, ku për të parën mund të procedohet edhe me vendim mosfillimi të çështjes, pasi prokurori bën verifikimet përkatëse,

¹ Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. 3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura. 4. Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre.

ndërsa në rastin e dytë duhen zhvilluar hetime dhe në raport me përfundimin e tyre procesohet me kërkesë për pushim për një nga shkaqet që parashikon neni 290 i Kodit të Procedurës Penale apo nëse çështja duhet t'i dërgohet gjykatës. Në vlerësimin e trupit gjykues mungesa e një analize ligjore të mirarsyetuar e verifikuar nën rrethanat e mësipërme, në çështjet konkrete kanë passjellë edhe prishjen e vendimeve nga gjykata, që më pas kanë rezultuar në regjistrimin e tyre dhe kërkesën për pushim, nga subjekti. Kjo mangësi në vlerësimin e trupit gjykues, pavarësisht vendimmarrjes, ka passjellë defekt të tij edhe në drejtim të organizimit me efektivitet të çështjes.

31. Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore, kriter i parashikuar në pikën 2 të nenit 73, si dhe në kriterin e aftësive organizative sipas pikës 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

32. Lidhur me procedimin penal nr. ***, mbi bazë të kallëzimit të shtetasit F.V, denoncuar² nga shtetasi LL.M (K), Komisioni administroi kopje të fashikullit penal³, ku nga verifikimi i akteve konstatoi se çështja është marrë për t'u hetuar nga subjekti i rivlerësimit në datën 25.1.2018, sipas vendimit të po kësaj date mbi zëvendësimin e prokurorit.

32.1 Për këtë çështje duket se janë kryer veprime hetimore në intervale të gjata kohore, për shkak të mospërmbushjes së çdo veprimi hetimor brenda afatit të përcaktuar e që, për rrjedhojë, ka derivuar në shtyrjen e radhës. Kjo situatë ka vijuar deri në datën 8.3.2022, kur subjekti ka kërkuar bazuar në nenet 17 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr. 97/2016, dorëheqjen⁴ dhe zëvendësimin e tij nga hetimi i këtij procedimi penal nën argumentin se pranë ILD-së ishte depozituar ankesë nga përfaqësuesi ligjor i shtetasës K.L (K). ILD-ja⁵ ka konfirmuar përfundimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit ndaj subjektit për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “ë” e ligjit nr. 96/2016, duke e referuar për vlerësimin etik profesional.

32.2 Në lidhje me ecurinë e çështjes rezultoi se subjekti ka dërguar në gjykatë në datën 5.5.2022 kërkesën për pushimin e çështjes.

32.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin datë 18.4.2023, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” (bëhet fjalë për një vendim të KKKPronave të vitit 1992 apo 1994, në favor të familjes K.), parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Po në këtë vendim organit të akuzës i është lënë afat 90 ditë për kryerjen e hetimeve. Gjykata ka konkluduar se nuk janë kryer të gjithë hetimet për të provuar ekzistencën e dokumentit të falsifikuar, pasi akti i ekspertimit grafik nuk është i plotë.

32.4 Gjykata ka lënë si detyrë caktimin e një grupi ekspertësh për kryerjen e aktit të ekspertimit për të provuar faktin nëse vendimi nr. 59 në favor të subjektit DH.K, dhënë nga KKKPronave, është shkruar nga e njëjta makinë shkrimi që janë shkruar vendimet e tjera të marra në të njëjtën

² Nr. *** prot., datë 22.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit dhe nr. *** prot., datë 22.7.2021, përcjellë nga Komisioneri Publik me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2021, pranë Komisionit.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴ Kjo kërkesë rezultoi e papranuar nga drejtuesi i organit të akuzës, në datën 14.3.2022, për shkak se në të nuk është paraqitur ndonjë e dhënë për njëanshmëri në çështje apo qenia e tij në ndonjë nga rastet e parashikuara nga nenet 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

datë, si dhe ato të marra tre muajt e fundit, nëse akti është i falsifikuar ose jo dhe cila pjesë është e falsifikuar.

32.5 Po ashtu, gjykata ka vlerësuar se prokurori pas kryerjes së këtyre veprimeve mund të vlerësojë nëse ka vend për të tjera hetime. Gjkata ka vlerësuar se nuk janë kryer hetime shteruese për të konkluduar në lidhje me faktin nëse ndodhemi përpara veprës penale të kallëzuar apo fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale.

32.6 Më tej, kjo çështje ka vijuar nga subjekti i rivlerësimit, por ka përfunduar përsëri me kërkesë për pushimin e saj nga një tjetër prokuror.

32.7 Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit se në këtë rast kanë ndikuar disa faktorë të tillë si: (i) jemi para hetimit pa autor; (ii) ka pasur ngarkesë në punë, me raste të shumta të gatishmërisë për masat e sigurimit, përfaqësime në gjykatë; (iii) mungesa e prokurorëve edhe si rezultat i *Vetting*-ut, etj. – trupi gjykues ka konstatuar disa rrethana/elemente, që dëshmojnë mangësi profesionale të subjektit, konkretisht:

32.7.1 Nga verifikimi i të dhënave të administruara minimalisht për vitin 2019 rezulton se subjekti nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor.

32.7.2 Të dhënat statistikore për volum të lartë pune, në raport me konstatimin për vitin 2019, nuk gjenden nga trupi gjykues si shkaqe që justifikojnë këtë zvarritje të çështjes.

32.7.3 Trupi gjykues çmon se vonesat në veprimet e kryera që kanë ardhur si pasojë e ngarkesës në punë tregojnë më së paku mangësi të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, të cilat, bazuar në parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, maten duke u bazuar në plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet një çështjeje dhe kohën për marrjen e një vendimi përfundimtar për çështjen. Mangësitë e karakterit organizativ dhe të lidhura me mosveprimin me efikasitet kanë sjellë mospërmbushjen e detyrave të tij si prokuror sipas nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale.

32.7.4 Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime shteruese për të konkluduar në lidhje me faktin nëse ndodhemi përpara veprës penale të kallëzuar apo fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale.

32.7.5 Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 dhe në pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

33. Lidhur me procedimin penal pa autor nr. ***⁶, si rezultat i bashkimit me procedimin nr. ***⁷, regjistruar për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Shpërdorimi i detyrës”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 244, 259, 248 dhe 287 të Kodit Penal, hetuar nga subjekti i rivlerësimit pas zëvendësimit të prokurorit të mëparshëm⁷, Komisionit i rezultoi si vijon:

⁶ Regjistruar më parë në datën 29.5.2017 për veprat penale të parashikuara nga nenet 181/a dhe 248 të Kodit Penal.

⁷ E ndjera E.K., e cila në datën 11.9.2017 i ka paraqitur drejtuesit të prokurorisë kërkesën për zëvendësim dhe, për pasojë, është kryer zëvendësimi me prokurorin Anton Pali dhe hetimi ka vijuar prej tij dhe drejtuesit të prokurorisë D.G.

33.1 Me urdhrin datë 5.9.2017⁸, “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, rezulton se është konkluduar në disa të dhëna, të cilat kanë çuar urdhëruesit në regjistrimin e emrave të personave nën hetim në regjistrin e njoftimit të veprave penale, pasqyruar edhe veprat penale të dyshuara në ngarkim të tyre.

33.2 Në datën 12.12.2017, subjekti i rivlerësimit dhe drejtuesi i prokurorisë kanë kërkuar pushimin e procedimit penal, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 11.1.2018, ka vendosur “Pranimin e kërkesës, pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2017”, vendim i cili rezulton se ka marrë formë të prerë.

33.3 SPAK-u, për hetimin e kësaj çështjeje, regjistruar si procedim penal nr. ***, ka konfirmuar faktin se: (i) nga dy shoqëritë janë pranuar fatura shitjeje nga të tjera kompani⁹, të cilat kanë rezultuar të lidhura më të pandehurin K; (ii) shtetasit S.G dhe K.Z në bashkëpunim me shtetasin M.M kanë përdorur skemën fiktive të kryerjes së pagesave të realizuara ndërmjet dy shoqërive për të mbuluar dhe fshehur natyrën e vërtetë të origjinës së paligjshme të shumave monetare, natyrën e vërtetë të transferimit dhe zhvendosjes së tyre, të cilat në të vërtetë përbëjnë përfitim të parregullt, si dhe, rrjedhimisht, edhe produkt të veprës penale të korrupsionit dhe pastrimit të produkteve të veprës penale.

33.4 Rezulton se me vendimin e saj Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka deklaruar fajtor shtetasit M.M, S.G dhe K.Z, duke i dënuar¹⁰ për veprën penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 245-25 i Kodit Penal dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. Konstatohet se kjo gjykatë në vendimin e saj ka arsyetuar edhe mbi hetimin e Prokurorisë së Rrethit Elbasan, duke argumentuar se nuk është hetuar¹¹ për të njëjtat fakte e rrethana.

33.5 Komisioni, në analizë të të dhënave të dala në raport me shpjegimet e subjektit në këtë çështje, konstaton defekte që cenojnë indikatorët e kriterit profesional të subjektit, konkretisht:

33.5.1 Mangësi në drejtim të aftësisë së subjektit për të ndërmarrë logjikisht hetimin për të ndërtuar skemën hetimore në drejtim të pranimit nga kompania koncesionare të faturave fiktive për punime të pakryera, që si burim kishin buxhetin e shtetit dhe që shkonin në interes të drejtuesve institucionalë, duke mos u kufizuar kështu vetëm në hetimin, nëse burimi i investimit të inceneratorit vinte nga ndonjë *veprimtari kriminale*, sikurse pretendohet nga subjekti.

33.5.2 Mangësi që cenon analizën ligjore të subjektit lidhur me çështjen e kompetencës, pasi në ndryshim nga sa pretendon subjekti se shtrirja e hetimit për zyrtarët nuk ishte në kompetencën e Prokurorisë së Rrethit Elbasan, trupi gjykues vlerëson se vetëm pasi të ishin kryer hetimet e nevojshme e të logjishme do të duhej të konkludohej mbi ndarjen e çështjes dhe kalimin e saj Prokurorisë për Krimet e Rënda për atë pjesë të hetimit, që për nga vepra penale ishte në kompetencë të kësaj së fundit.

⁸ Nxjerrë përpara marrjes së procedimit për hetim nga subjekti i rivlerësimit.

⁹ “***” sh.p.k., “***” sh.p.k., “***”, “***” sh.p.k.

¹⁰ M.M me 10 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406/1 të këtij Kodi është dënuar me 6 vjet e 8 muaj; S.G me 7 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal është dënuar me 4 vjet e 8 muaj; K.Z me 10 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal është dënuar me 6 vjet e 8 muaj.

¹¹ Nuk është hetuar mbi ligjshmërinë e koncesionit, pozitën e ministrit të Mjedisit në këtë marrëdhënie kontraktore, përfitimin e shumave në mënyrë të padrejtë prej tij nëpërmjet bashkëpunimit me kompaninë koncesionare dhe krijimit të kompanive të tjera për të fshehur e transferuar paratë e premtuara atij në këmbim të marrjes së këtij koncesioni. Gjykata ka cilësuar se është hetuar në drejtim të moskryerjes së detyrave nga organet tatimore të komunës ku do të ndërtohej impianti etj.

33.5.3 Trupi gjykues çmon se konstatimet mbi këtë procedim penal duket se dëshmojnë defekte në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, konkretisht në ndërtimin e hetimit, duke munguar në kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse dhe në harmoni me faktet dhe nevojat hetimore të materialeve ekzistuese në dosje, duke shfaqur mangësi në drejtim të përmbushjes së kriterit ligjor sipas pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”*.

34. Në përfundim të analizimit të dokumenteve ligjore të parashtruara më lart, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësisë profesionale sipas përcaktimeve të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se mangësitë e konstatuara në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë kryesisht të lidhura me:

a) Mungesën e analizës së mirarsyetuar ligjore, e cila ka cenuar vendimet e subjektit për shkak të mosinterpretimit të saktë të dispozitës konkrete ligjore në raport me rrethanat e kallëzuar, ku si pasojë e këtij konstatimi ky defekt cenon edhe organizimin me efektivitet të çështjes.

b) Mungesën e aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit për të përballuar ngarkesën në punë në mënyrë që të arrihet efektiviteti mbi procedurat hetimore brenda afatit të arsyeshëm, bazuar në parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

c) Mungesën e aftësisë të tij lidhur me ndërtimin e skemës së hetimit për të mbledhur provat e duhura e të nevojshme për zbardhjen e plotë të çështjes.

35. Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore, kriter i parashikuar në pikën 2 të nenit 73, si dhe në kriterin e aftësisë organizative sipas pikës 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

36. Duke analizuar këto mangësi në raport me të gjitha çështjet e tjera të analizuara prej Komisionit, edhe në kuadër të verifikimit të denoncimeve, si dhe duke pasur në konsideratë raportin e hartuar për çështjet e përzgjedhura me short e të dorëzuara prej vetë subjektit, ngarkesën e tij të punës, peshën e këtyre mangësive në zgjidhjet e çështjeve konkrete dhe pasojat e ardhura, Komisioni çmon se në këtë rast duhet të zbatohet standardi i përdorur nga Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj në paragrafin 54 të vendimit nr. 2/2017, sipas të cilit: *“Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale [shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias]”*.

37. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues i Komisionit çmon se mangësitë e konstatuara kualifikohen të një niveli “me mangësi” të kriterit të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe mund të plotësohen/shërohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës brenda një viti. Në mbështetje të këtij konkluzioni, trupi gjykues vlerëson se ndaj subjektit të

rivlerësimet duhet të jepet masa disiplinore e pezullimit nga detyra, e parashikuar në nenin 58, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, mbështetur në burimet e vlerësimit, rezultatet e hetimit, prapësimet e subjektit të rivlerësimit me shkrim dhe në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bisedoi në prani të vëzhguesit ndërkombëtar marrjen e vendimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aftësitë e tij profesionale, mangësi të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “b” e nenit 44, si dhe të nenit 60, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të z. Anton Pali për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt do të përfundojë bazuar mbi të tria kriteret e vlerësimit.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka